

Kryetar me votat e grave

Tryezë në Pogradec në kuadër të projektit "Fuqizimi i gruas", "Po, Ne jemi"



Lexoni në faqen 3

Personazh

Si na lidhi kënga me Irma Libohovën



Angji Zamjanova e rritur jetime në qytetin e Korçës sot punon roje shkolle. Si një femër që ruan qetësinë e shkollës, u munduam që ta gjejmë dhe t'i bënim një portret.

Lexoni në faqen 4

Arsimi

Mësonjëtorja e parë bëhet 122-vjeçare



Lexoni në faqen 2



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Bashkia Pogradec
Ndërmarrja e Taksa-Tregjeve

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë bizneset në bazë të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 për procedurat tatimore të gjitha subjektet e biznesit të vogël të regjistruhen në Ndërmarrjen e Taksa-Tregjeve Bashkia Pogradec deri në datën 20.03.2009. Mbas kësaj date do të ketë penalitete.

SUPLEMENT



Edhe unë jam PJESEMARRES

Qytetarët monitorojnë

Miratohet buxheti faktik i vitit 2008

Lexoni në faqen 5

Filial i Universitetit "Fan.S.Noli" në Pogradec

Lexoni në faqen 6

Pyetje-përgjigje

Emblema është një, ndërsa simbole qyteti ka shumë

Lexoni në faqen 8

Ylberi pogradecar (mbresa nga një mbledhje)

Lexoni në faqen 9

LIGJI 9936 datë 26.6.2008

Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë

Lexoni në faqet 10-11-12

Mësonjëtorja e parë bëhet 122-vjeçare



Në këtë përvjetor nuk kanë munguar vizitorët nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, përveç nxënësve e mësuesve të rajonit dhe të vendit.

Përgjegjësi i Mësonjëtores Pirro Naumi u shpreh se në kuadrin edhe të turizmit patriotik muzeu i mësonjëtores i ka hapur dyert dhe ka pritur mjaft vizitorë nga trevat shqiptare dhe të vendit. Vetëm në datën 7 mars numri i vizitorëve arriti rreth një mijë.

Në kuadrin e këtij përvjetori u hapën dy ekspozita. Një me piktura të dy piktorëve pogradecarë dhe një me koleksionistët e shoqatës mbarëkombëtare të koleksionistëve që sollën objekte të paeksponuara më parë, që kishin të bënin me rrugën e arsimit shqiptar. Disa herë kanë hapur ekspozita në qytetin e Korçës dy piktorët pogradecarë. Me 40 piktura nga 20 secili piktorët Anastas Konstandini dhe Vangjo Vasili tërhoqën mjaft vizitorë.

I vetmi politikan që e vizitoi Mësonjtoren në këtë përvjetor ishte Edi Rama. Festa ndau mësuesit. Ata të majtët e festuan para oborrit të Mësonjtore me kryetarin Rama, ndërsa ata të djathtët në një lokal me prefekten.

Bie tregu i apartamenteve

Janë 700 apartamente të ngritura nga firmat e ndërtimit që kanë mbetur pa u shitur, në qytetin e Korçës. Rënia e tregut të apartamenteve ka vënë në vështirësi biznesin e ndërtimit. Rënia e blerjes ka ardhur dhe si rezultat i ndërprerjes së burimeve financiare nga ana e emigrantëve si rezultat i krizës ekonomike që ka prekur vendet ku ata jetojnë dhe punojnë. Biznesi i ndërtimit lehtëson

blerësit nëse ata e japin shumën njëherësh në dorë duke bërë edhe zbritje. Vlera e një metri katror banesë varion sipas zonave ku është ngritur apartamenti. Ajo lëviz nga 40 mijë deri në 55 mijë lekë. Sipas Lida Kushes biznesmene ndërtimi dhe kryetare e shoqatës së ndërtuesve "ulja e tregut ka ardhur dhe si rezultat i shtimit të firmave të ndërtimit dhe kërkesës së pakët për të blerë hyrje të reja".

Ta gëzojmë edhe televizorin



Taksa për televizorin për qytetarët e Korçës është shënuar në faturën e energjisë elektrike. Një pjesë e qytetarëve, të cilët nuk e lexuan si shtesë këtë taksë, u ankuan se e kishin të lartë faturën e energjisë. Por kur panë se shuma që kishin për të paguar ishte mbledhur me një shifër standarte për të gjithë qytetarët, atëherë ata e kuptuan se edhe kjo taksë ishte pak e kripur. Nga 400 lekë që ka qenë para dy vitesh, vitin e kaluar u bë 500 lekë dhe këtë vit ajo është ngritur 600 lekë. Këtë taksë e ka vendosur qeveria.

Në qytetin e Korçës taksa e televizorit do të vilet po aq sa do të vilen dhe faturat e energjisë elektrike. Vjelja e kësaj takse mund të merret si shembull pasi mund të jetë taksa me përqindje më të lartë që do të realizohet vjelja. Faturat e energjisë e kalojnë shifrën e 95%. Pse mos e gëzojmë edhe televizorin?

Radhë për mandate, por asnjë kartë identiteti

Proçesi i kartave të identitetit ka nisur në qytetin e Korçës. Madje nuk është shmangur edhe radha. Mbaron punë kur hyn të aplikosh, por jashtë radha nuk shuhet. Aplikimi ka nisur që më datën 13 shkurt, por deri tani asnjë kartë identiteti nuk është provuar të merret

nga qytetarët.

Ata janë në pritje të marrjes së saj dhe për çdo ditë venë e pyesin. Vonesat në marrjen e kartave të identitetit sjellin shqetësime tek emigrantët që kanë aplikuar, pasi ata i kanë ditët të numëruara.

Digjet dyqani me ushqime

Një zjarr i rënë në fshatin Libonik ka bërë hi një dyqan ushqimor. Zjarri ka rënë në orët e vona të natës dhe flakët kanë përpirë të gjitha ushqimet që ndodheshin brenda. Dyqani ushqimor në pronësi të Xhemal Kangetarit ka marrë zjarr si rezultat i një shkëndije elektrike që është shkaktuar nga luhatja e tensionit.

Mbytet në rezervuar nëna e tre fëmijëve

Gjendet e mbytur në rezervuarin e fshatit pas dy ditësh e zhdukur nga shtëpia. Në ujrat e rezervuarit të fshatit Libonik u gjend nga familjarët e saj 48-vjeçarja Violeta Hoxhalli. E ndarë nga familjarët që prej dy ditësh pa lënë adresë ku do të shkonte, më pas është gjendur e mbytur në rezervuar. Viktima nuk ka vuajtur nga ndonjë sëmundje dhe nuk kishte konflikte që të merrte një veprim të tillë për t'i dhënë fund jetës. Si shkak mund të ketë shërbyer ndoshta humbja e nënës para tre muajsh.

Nuk shkon kafja pa duhan

Kohë më parë kemi shkruar se ka kontrabandë të vogël dhe herë pas here kapen furgona me ushqime dhe rroba, por nuk ishte kapur kontrabanda e madhe që kalon me maune. Së fundi edhe kontrabanda me maune u ndalua në doganë. Maunia u kap në doganën e Kapshticës, ku një sasi prej 27 ton kafe u tentua të kalonte e maskuar me hekur. Ky rast i kapjes së maunes me kafe kontrabandë është për t'u regjistruar. Kontrabanda e madhe po vihet në fre. Plot 27 ton kafe kontrabandë është sekuestruar në doganën e Kapshticës. Kjo ka qenë sasia më e madhe që është shkarkuar nga maunet. Pronarët të cilët tentuan të fusnin kafën kontrabandë e kishin fshehur nën shufra hekuri. Pasi kanë shkarkuar shufrat e hekurit, doganierët kanë gjetur thasët me kafe.

Tryeza e pestë e grave të shoqatës "Refleksione", u mbajt në datën 12 mars në qytetin e Pogradecit. "Fuqizimi i Gruas", është projekti më i ri që "Refleksione" ka nisur të zbatojë.

Qëllimi i këtij projekti është identifikimi i problemeve më të rëndësishme që përjetojnë gratë shqiptare sot dhe gjetja e mënyrave sa më të drejta dhe efektive për adresimin e tyre me synim lobimin dhe avokatin për rrugëzgjdhje. Projekti mbështetet financiarisht nga USAID.



Kryetar me votat e grave

Tryezë në Pogradec në kuadër të projektit "Fuqizimi i gruas", "Po, Ne jemi"

Programi i tryezës përfshinte prezantimin e metodologjisë së tryezës, punë në grupe, përmbledhje të temave më të rëndësishme të nxjerra nga puna në grup dhe përzgjedhjen e katër prej temave më të votuara.

Drejtorja Ekzekutive e "Refleksione" Monika Kocaqi hapi tryezën dhe sqaroi thelbin e kësaj tryeze. Pjesëmarrësit u ndanë në 6 grupe pune. Në çdo grup kishte nga një moderatore që drejtoi debatin. Dy moderatore ishin nga "Unë Gruaja" e Pogradecit në ndihmë të kësaj veprimtarie që u zhvillua. Përfaqësimi ishte i gjerë, me gra nga Pogradeci, Prrenjasi, Librazhdi, Elbasani dhe nga Tirana. Përfaqësimi në tryezën e pestë të "Refleksione", që u mbajt në qytetin e Pogradecit, ishte nga të gjitha shtresat e grave duke filluar që nga biznesmenet e deri tek intelektualet. Nuk mungonin dhe gra të thjeshta dhe me aftësi të kufizuara. Projekti "Fuqizimi i Gruas", shtrihet në 6 rrethe të vendit dhe kjo është tryeza e pestë që zhvillohet.

Qëllimi është që të dalë në dukje realiteti me të cilin ndeshet sot gruaja shqiptare. Gruaja duhet të ngrejë dhe të nxjerrë më në pah zërin e saj. Nga aktiviteti do të identifikoheshin disa nga problemet më urgjente, jo thjesht duke bërë një raport. Tryeza u përqëndrua rreth problemeve më specifike të Pogradecit. Sikurse u tha në aktivitet, nuk janë njësoj problemet që kanë gratë e Librazhdit, apo të Rrëshenit me ato të Shkodrës e Kukësit, Beratit, apo të Pukës.

Nga puna nëpër grupe dolën disa probleme që janë më emergjente që duhet të mbahen parasysh për të

fuqizuar rolin e gruas. Problemet e identifikuar ishin: turizmi familjar, papunësia e grave, varfëria, mungesa në vetvlerësimin e gruas, mosintegrimi i gruas në nivelin ekonomik, mentaliteti, pozicionimi i gruas në familje dhe në shoqëri, pjesëmarrja e ulët në vendimarrje në rangun e pushtetit lokal.

Kodi i ri zgjedhor përcakton si kufi që gratë të përfaqësohen në masën 30%, por sa do të realizohet kjo në praktikë? Kodi i ri zgjedhor për herë të parë parashikon që listat e kandidatëve që paraqet çdo forcë politike për zgjedhjet në Kuvend, për çdo zonë zgjedhore duhet të kenë të paktën 30% gra, dhe/ose një në tre emra të parë të listës të jetë grua. Në rast se lista

Shembuj nga jeta e përditshme

-Në komunën e Funarit në Elbasan në Këshillin e Komunës nuk kishte asnjë grua të përfaqësuar. Kryetari i komunës ishte shprehur se ai ishte bërë kryetar me votat e grave.

-Një grua denoncon rrahjen që i kishte bërë bashkëshorti. Por ai ishte polic. Ajo nuk donte që të merrej masë ndaj tij, nuk donte që t'i hiqnin armën(!)

-Një vajzë nga fshati Vashtëmi kishte fjetur një natë jashtë në lulishtet e Elbasanit. Ajo kishte udhëtuar me furgon për në Tiranë, por shoferi nuk i kishte marrë lekë për biletën. Vajzën e torturonte babai me vëllanë, prandaj ajo kishte kërkuar një qendër rehabilitimi. Shoferi i furgonit e kishte dorëzuar në polici.

shumëemërore për zgjedhjet në kuvend nuk i përmbush këto kriteret, atëherë KOZ-ja do ta refuzojë këtë listë.

Një fushë ku gruaja duhet të gjejë më shumë veten është zgjerimi i kapaciteteve për turizmin familjar. Por siç u theksua, probleme të mprehta janë edhe dhuna në familje, papunësia, mungesa e shërbimeve sociale të grave.

Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu për mungesën e zbatimit të legjislacionit, diskriminimin e grave me aftësi të kufizuara dhe rome, mungesën e një arsimit për të fiksur vende pune të qëndrueshme dhe diskriminimin gjinor.

U kërkua zbatimi i ligjit për mbrojtjen e gruas; këtu ndikon edhe njohja apo mosnjohja e këtij ligji.

Pasoja e emigracionit shpesh kanë qenë tragjike. Mungesa e bashkëshortit në familje, në disa raste ka sjellë prishjen të familjeve dhe deri në masakrim të grave pasi burrat janë kthyer nga kurbeti i gjatë. Kanë ndodhur edhe raste dramatike. Gratë përjetojnë dhimbje dhe dhunë.

Grupet paraqitën nga tre pika të përzgjedhura, që u mbrojtën nga një përfaqësues i grupit. Në fund u votua për katër pikat më kryesore ku numrin më të madh të votave e morën:

Pjesëmarrja e ulët e grave në vendimarrje 21 vota

Papunësia 15 vota

Dhuna në familje 12 vota

Pasoja e migracionit 10 vota

Pjesëmarrësit shkëmbyen mendime dhe përvojë për veprimtari të përbashkëta edhe në qytetet e Librazhdit e Elbasanit.

Pëllumb Çuni

PRONONCIME

Monika Kocaqi, Drejtore Ekzekutive e shoqatës "Refleksione":

"Në Pogradec, në të pestën tryezë rajonale, gjetëm një mjedis me nivel të lartë. Pjesëmarrëset e njohin situatën dhe ia arritëm qëllimit të vënë për projektin."

Mimoza Shuli, biznesmene:

"Unë e kam nisur biznesin me ëmbëlsira dhe sot kam një hotel që për mua është një gjë e madhe. Unë me mbështetjen e bashkëshortit kam patur arritje këto 18 vite. Kam vënë re se kur u vjen ora për të ikur grave që kam punësuar, ato pushtohen nga një ndjenjë frike dhe paniku; duan të ikin sa më parë se mos vonohen. Unë sivjet mbaroj ekonomikun, të lartën në Elbasan. Gratë kanë mundësi dhe të ndjekin arsimin e lartë. Mundësitë janë që gratë të gjejnë veten."

Natasha Kanina:

"Gruan duhet ta përkrahë familja, shoqëria, shteti, që të bëhet biznesmene dhe një intelektuale me vlerë. Tek gratë sot ekziston një dhunë psikologjike, shpirtërore. Gruaja shqetësohet më shumë në familje, kur nuk arrin të mbyllë 15-ditëshin me të ardhurat. Kur nuk arrin të dalë ky 15-ditësh, ajo ndjehet e dhunuar. E dhunuar ndjehet edhe pse është brenda mureve të shtëpisë. Edhe kur fëmija nuk i bën detyrat e nuk vete në shkollë. Brenda mureve të shtëpisë gruaja është e dhunuar, por ajo ka energji që duhet të shfrytëzohen në dobi të shoqërisë."

Bardhylka Kospiri

përfaqësuese me Aftësi të Kufizuara nga Tirana:

"Gratë me aftësi të kufizuara duhet të mbështeten më shumë që të integrohen me pjesën tjetër. Ne vërtet trajtohemi ekonomikisht e nuk jemi të harruara nga shteti dhe shoqëria, por edhe gratë me aftësi të kufizuara duhet të marrin pjesë në vendimarrjet politike. Të jemi më të pranishme, të thyejmë paragjykimet. Mos të ndrydhemi nga mentalitetet që ekzistojnë për kategorinë tonë."

PRONONCIME

Flet një jetime nga Korça

Si na lidhi kënga me Irma Libohovën

Angji Zamjanova e rritur jetime në qytetin e Korçës sot punon roje shkolle. Si një femër që ruan qetësinë e shkollës, u munduam që ta gjejmë dhe t'i bënim një portret.

Angji, na foli për rrjedhën e jetës së saj. Ajo tha se kishte ardhur nga befotrofi i Pogradecit dhe ishte rritur si jetime në qytetin e Korçës; prej 18 vitesh ajo ka ruajtur derën e shkollës teknologjike "Isuf Gjata". Ajo që na bëri më tepër përshtypje ishte se na foli si një mikeshë e Irma Libohovës. Një fansja e saj që prej 30 vitesh. "Unë nuk e kam ndjerë asnjëherë mungesën e prindërve apo të një motre. Irma më ka marrë edhe në Tiranë për kurime e mjekime. Më ka mbajtur në shtëpi të saj. Sa zemërgjerë ajo, po aq dhe bashkëshorti i saj, Besniku." Në frontet më të vështira si roje ka përballuar me sukses çdo vështirësi dhe ka ruajtur qetësinë e nxënësve dhe të mësuesve. Nuk lejon që të bëhen rrëmuja në mjediset e shkollës. Po e nisim bisedën për njohjet dhe miqësinë e saj me këngëtaresh Irma Libohova.

-Si e keni njohur Irma Libohovën?

-Gjatë koncerteve që Irma jepte në qytetin e Korçës, unë u bëra një nga fanset e saj. Edhe kur jepeshin emisione me këngë të saj në televizor, unë e ndiqja. Para 30 viteve nisi njohja jonë, e cila erdhi duke u forcuar. Irma më hyri në zemër dhe më plotësoi një boshllëk që mua më mungonte prej vitesh. Po edhe ajo më hapi zemrën dhe derën e shtëpisë, kur unë kam patur halle.

-Si ju ka ndihmuar?

-Para dy vitesh unë pata dhimbje të forta në kokë. Kur këmbenim biseda në telefon Irma më pyet për shëndetin. Nuk jam mirë, i them. Ajo më tha që të nisesha urgjentisht në Tiranë. Unë u stepa se nuk kisha mundësi që të mbrrija sepse nuk kish kush të më shoqëronte. Ajo më tha se është Irma në Tiranë. Më bëri skaner dhe EZHENë. Unë isha vetëm një paciente; me mjekët e infermieret u mor Irma. Pasi mbarova kontrollet, ajo më mbajti në shtëpi një muaj, ku më siguroi të tërë mjekimin. Kur u ktheva në Korçë ajo më merrte dy herë në ditë në telefon duke më dhënë kurajo e duke më pyetur për shëndetin. U bëmë miq shtëpie nga kënga. Për mua ajo nuk është vetëm një këngëtare e madhe, por dhe një bamirëse me zemër humane.

-Kur jeni takuar për herë të fundit?

-Mesazhi i saj i fundit është urimi



për 8 Marsin. Por unë në 2008 u operova në Korçë nga hernia epigastrike. Nuk i thashë gjë Irmës për operimin. Kur dola nga spitali i Korçës nuk dola mirë. Më kishin lënë me defekt. Kur u gjenda në vështirësi fola me këngëtaresh dhe ia hapa zemrën. Më ftoi në Tiranë, ku unë bëra operim të dytë dhe Irma m'u gjend pranë si një motër e shkuar motrës. Si kreuva operimin e dytë më mori në shtëpi, ku më mbajti nën kontroll e më mjekoi me ndihmën dhe kujdesin e saj. Unë jam munduar tërë këta vite që t'i bëj një dhuratë të mirë, por ende nuk e kam gjetur një të tillë.

-Po në bllok paskeni dhe vargje. Shkruani poezi?

-Lexoj poezi se më pëlqejnë dhe kur ndonjë vjershë më rimon e më ngroh zemrën, them që ja, këtë ta këndonte Irma. Unë kam nisur të hedh disa vargje që kam ndërmend t'ia bëj si dhuratë Irmës që ajo t'i bëjë këngë. Një dëshirë është, por do ta realizoj.

-Mund të lexojmë ndonjë varg?

-Patjetër, hidhu një sy.

-Paskë dhe kartvizitën e Irmës në bllok. Titullin s'e paskeni gjetur akoma, siç duket prisni ta mbaroni e

pastaj ta pagëzoni vjershën.

-Kam fshirë disa tituj. Por do t'ia lë Irmës ta vendosë, ose le të mbeten ashtu pa titull.

-Si fillim nuk i keni keq vargjet. A mund të marrim disa prej tyre?

-Patjetër që mund të zgjidhni.

Nga blloku i Angji Zamjanovës shkëpusim këto vargje:

"Dy lotë, det me ëndrra
Dy zemra mal me këngë.

Thahet loti

Shembet mali

Kënga mbetet e pashuar

E pashuar si prush zjarri..."

-Poezinë e bëjnë ndjenjat, përkushtimet, ngjarjet. A do të vazhdoni të shkruani?

-Veç dëshirës për të mbajtur ditar, kam patur dhe për të shkruar vjersha, por dua të mbaroj këtë që kam nisur për Irmën. Pres një ditë që Irmës ose mund t'ia nis me mesazh, ose po u takuam në Tiranë a në Korçë. Sot që unë mora mesazhin për 8 Marsin, Irma është në Kosovë, që nga Peja më shkroi. Unë e falënderoj me zemër se jo vetëm që kam qenë një fansja e saj dhe mbetem, por u bëra dhe një mikeshë. Unë jam jetime. Njeriu nuk

braktiset lehtë në jetë. Të braktis dhe nëna, por ja që gjen një këngëtare që të hyn në zemër dhe të hap portën e saj.

-Si një femër që ruani rendin në shkollë a keni vështirësi?

-Në çdo punë ka vështirësi dhe probleme, por unë jam munduar që të jem tepër korrekte si me kolektivin e mësuesve ashtu dhe me nxënësit. Nuk toleroj kur ka shkelje. Nuk lejoj që në shkollë të vijë persona që s'kanë të bëjnë me shkollën. Nuk u bëj kurrë shoqëri. Nuk i afroj në mjediset pranë shkollës. Deri tani jam e kënaqur me punën time dhe me gatishmërinë që kam treguar për të kryer rojen e shkollës. Edhe me turne e kam ndjekur punën.

-Po sot çfarë turni jeni?

-Unë zakonisht kam punuar turni i parë, por ka një muaj që më kanë kaluar turni i dytë. Këto ditë dimri kur erret shpejt është më i vështiri. Unë nuk e refuzova turnin e dytë. Dua të bind çdokënd me punën time. Kur dëgjoj këngët e Irmës sikur bëhem me krah dhe marr forcë për të mbijetuar e përballuar çdo vështirësi.

P. Çuni



Edhe unë jam PJESEMARRES



Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.

Filial i Universitetit "Fan.S.Noli" në Pogradec

Qytetarët monitorojnë

Miratohet buxheti faktik i vitit 2008



Rendi i ditës

1-Projekt-vendim "Për hapjen në qytetin e Pogradecit të filialit të Universitetit "Fan.S.Noli", Fakulteti Ekonomik, Programi i studimit të Turizmit".

2-Projekt-vendim "Për ndihmat ekonomike për muajt dhjetor 2008 e janar 2009"

3-Projekt-vendim "Mbi miratimin e kërkesës së personave që do të vazhdojnë procedurën e privatizimit të banesave shtetërore që kanë mbetur pa privatizuar"

4-Projekt-vendim "Për ndryshimin në përbërjen e komisionit të licensave profesionale"

5-Projekt-vendim "Për miratimin e fondit total për realizimin e investimit" Rikonstruksion i stadiumit dhe ambienteve përreth tij lagja nr.1"

6-Projekt-vendim "Për miratimin e fondit total për realizimin e investimit "Rikonstruksion i lumit të qytetit"

7-Projekt-vendim "Për fillimin e procedurës së konkurrit për realizimin e veprave të artit përgjatë shëtitores "Fan Noli"

8-Analiza ekonomike për vitin 2008 dhe miratimi i buxhetit faktik të vitit 2008

9-Projekt-vendim "Për ndarjen e fondit që trashëgohet për vitin 2009"

10-Projekt-vendim "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit të imët ekonomik dhe inventarit në magazinë"

11-Projekt-vendim "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit të imët dhe ekonomik për ndërmarrjen e Punëve Publike"

12-Projekt-vendim "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit të imët dhe ekonomik për ndërmarrjen e Gjelbërim-Ndriçimit"

KUSH DEBATON?

Sallë e re për mbledhjet e këshillit të bashkisë

Ishte ky lajmi tjetër që u konfirmua në këtë mbledhje. Salla e mbledhjeve do të konceptohet si një sallë parlamenti me përmasa të vogla. Ajo do të ketë vendin ku do të operojnë këshilltarët, gazetarët dhe komuniteti. Një pjesë e këshilltarëve shprehën merakun se a do të jenë ata që do të marrin pjesë në sallën e re. Kryetari i Bashkisë i siguroi se salla do të mbarojë brenda këtij viti dhe ata patjetër që do të marrin pjesë në disa mbledhje dhe pas mandatit tjetër të ri nuk ka siguri a do të jenë të gjithë bashkë apo të tjerë do ta gëzojnë.

Vlerësim për buxhetin 2008

Nota të mira nga këshilltarët edhe për miratimin e pikës 8 "Analiza ekonomike për vitin 2008 dhe miratimi faktik i buxhetit 2008." Me mendimin e këshilltarëve të majtë se buxheti i 2008 ka patur arritje, u bashkuan dhe të krahut të djathtë ku u shprehën se edhe japim nota të mira për administratën dhe kryetarin e Bashkisë për mbylljen e buxhetit të vitit 2008.

Analiza e buxhetit 2008 u bë në mbledhjen e muajit dhjetor gjatë miratimit të buxhetit të vitit 2009, i cili u miratua në unanimitet votash nga të dy krahët.

Miratimi i buxhetit faktik për vitin 2008 u bë në bazë të këtyre treguesve:

1-Të ardhura gjithsej
350.738.816 lekë

vijon në faqen 12

Mbledhja e parë e Këshillit për vitin 2009 solli ndryshim në orarin e grumbullimit të këshilltarëve. Ajo nisi një orë para se orari tradicional, që ka qenë ora 10.

Jo të gjithë këshilltarët përfshihen në debate. Jo të gjithë shfaqin mendime apo oponencë për materialet që shtrohen për diskutim. Këshilltarët që flasin janë si të thuash me kokrra. Dëgjohen vetëm zërat e Kryetarit të këshillit të Bashkisë Gjergji Ilo, Kryetarit të Bashkisë Artan Shkëmbi, Syrja Pallës, Lefter Tanellarit, Todi Angjellarit, Vangjo Gushos. Dhe të tjerët përfshihen në debate si në kor, ku nuk merr vesh se çfarë kërkojnë dhe çfarë mendimi japin. Ose kur duan që të kundërshtojnë, kundërshtimi bëhet në grup dhe nuk debatohet të veçuar. Si vendoset qetësia, pas debatit-zhurmë ata bien përsëri në heshtje.



Filial i Universitetit "Fan.S.Noli" në Pogradec

Pogradeci qytet universitar

Një nismë e tillë u theksua nga këshilltarët, duhej të ishte marrë që më parë. Pogradeci ka sot 35 mijë banorë. Vetëm 20% e maturanëve frekuentojnë Universitetin e Korçës. Me hapjen e filialit të turizmit nuk do të venë studentët në Korçë, por do të vijnë pedagogët tek studentët. Synim është që në të ardhmen të zgjerohen degët e studimeve të larta në qytetin e Pogradecit. Si qytet universitar synohet që të thithen edhe studentët nga trevat shqiptare të Maqedonisë dhe Kosovës.

Hapja e filialit do të pasohet me dhënien e një fizionomie të një fakulteti dhe me një numër më të madh degësh. Prania e studentëve në qytet do të rrisë gjallërinë e tij dhe do të krijojë mundësitë për zgjerimin e bizneseve. U sollën përvoja nga hapja e filialeve të Sarandës dhe të Kukësit. Vetë drejtuesit e UK kishin qenë për të marrë përvojë në Sarandë. Bashkia për çeljen e filialit vë në dispozicion godinën. U soll përvoja e Sarandës ku Bashkia i ndihmonte studentët me 5 mijë lekë në muaj për strehimin.

Gjergji Ilo kërkoi që të merret shtëpia e ushtarakëve dhe të bëhet godinë mësimore. Kryetari i Bashkisë Artan Shkëmbi si një nga përkrahësit dhe inisiatorët për hapjen e filialit sqaroi se në perspektivë godina e maternitetit mbetet një mundësi për ta rikonstruktuar dhe përshtatur për mjedise akademike, pasi ministria e shëndetësisë ka premtuar që do ta zhvendosë maternitetin në godinën e spitalit civil.

Në këtë mbledhje iu hap rruga pranisë së filialit të ekonomikut për studim turizmi. Në fillim filiali do të ketë dy grupe studentësh. Bashkia mori përsipër godinën, ndërsa Universiteti "Fan Noli" mori përsipër stafin akademik. Prania e rektorit të Universitetit në mbledhjen e këshillit konkretizoi dhe bashkëpunimin e parë të rektoratit me Këshillin e Bashkisë. Jo më kot ishte vënë dhe pika e parë e rendit të ditës hapja në qytetin e Pogradecit të filialit të turizmit.

Por me hapjen e këtij filiali këshilltarët u shprehën entuzistë që të bëhet fakultet ekonomik apo dhe një qendër e trajnimit dhe kualifikimit të intelektualëve në të ardhmen. Pogradecit nuk i mungojnë intelektualët dhe vetëm nga qyteti i Pogradecit japin mësim 6 pedagogë efektivë dhe 7 si të jashtëm.

Rektori i "Fan Nolit" para këshilltarëve

Gjergji Mero:

"Hapja e një filiali të UK-së në qytetin e Pogradecit ka qenë dhe mbetet një dëshirë e madhe e pogradecarëve dhe e autoriteteve vendore. Kjo përligjet në radhë të parë me traditat arsimdashëse të banorëve të këtij qyteteti dhe trevave të tij, me faktin që në shkollat e mesme të rrethit të Pogradecit mbarojnë çdo vit qindra maturanët, me faktin se niveli i popullsisë me arsim të lartë në Pogradec është nga më lartat në shkallë republike dhe se Pogradeci në të gjitha kohrat ka nxjerrë intelektualë të shquar. Po duhet

shtuar se Pogradeci ka pozitë gjeografike mjaft të favorshme për zhvillimin e turizmit dhe është i pasur me shumë objekte historike dhe arkeologjike të njohura në Shqipëri dhe më gjerë. Hapja e filialit të UK-së në Pogradec është i mbështetur ligjërisht: në Ligjin për Arsimin e Lartë, neni 11 "Një institucion i arsimit të lartë ka të drejtë të hapë filialet e tij në rajone të tjera, jashtë selisë qendrore, për të ofruar programe të studimeve, kërkim shkencor e shërbime të ndryshme" dhe Statutin e UK-së, neni 10, ku



Rektori i "Fan Nolit" para këshilltarëve

përcaktohen qartë kriteret minimale që duhen plotësuar për të hapur një institucion të tillë dhe mënyra e funksionimit. Po kështu në dokumentin për strategjin e Arsimit të Lartë në Shqipëri thuhet se kjo është një nga detyrat e universiteteve rajonale. Hapat që kemi ndjekur për hapjen e filialit në Pogradec janë këto: Vendim i Këshillit të Fakultetit Ekonomik dhe Rregullorja mësimore e Pogramit të Studimit, vendim i Senatit Akademik të UK-së për hapjen e filialit dhe përcjellja e dokumentacionit në MASH. Vendim i Këshillit Bashkiak i qytetit të Pogradecit për hapjen e Filialit të UK-së, si dhe vendimi i Këshillit Bashkiak për ndërtesën ku do të hapet dhe do të zhvillojë veprimtarinë filiali, vendimi i këshillit Bashkiak për mbështetjen financiare të Filialit. Universiteti i Korçës do të mbështesë me të gjitha mundësitë hapjen dhe zhvillimin normal të veprimtarisë mësimore në këtë institucion. Filiali do të jetë pjesë përbërëse e fakultetit Ekonomik në selinë qendrore të UK-së. Pra,



organizimi, drejtimi dhe mbarëvajtja e Filialit është përgjegjësi e Fakultetit Ekonomik të UK-së dhe e departamentit përkatës. Mënyra e funksionimit të Filialit të UK-së në Pogradec do të përcaktohet në një pjesë të Rregullores së Studimeve të Universitetit "Fan S.Noli." Gjergji Ilo u shpreh se kjo është një ditë e shënuar për këshilltarët dhe për gjithë banorët e Pogradecit dhe të vëmë në

dispozicion të gjitha kapacitetet shoqërore e miqësore që të krijojmë kushte dhe hapësira për mbarëvajtjen e filialit të ri që do të hapet në muajin tetor të këtij viti. Nisja e kësaj rruge për ta bërë Pogradecin, qytet universitar do të na vërë para angazhimeve të mëdha për të krijuar kushte sa më të mira për studentët e rinj. Këshilltarët bënë pyetje rreth funksionimit dhe fondeve për pagesat e pedagogëve.

V E N D I M I

Bashkia do të vërë në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor mjediset e Qendrës Rinore, ish shtëpia e Pionierit. Bashkia do të japë dhe mbështetje financiare për funksionimin e këtij filiali, sidomos për studentët që do të vijnë, pasi nuk sigurohen konvikte për fjetjen e tyre.

Filiali i ri do të ketë si fillim dy grupe studentësh. Këshilli i Bashkisë vendosi pa asnjë votë kundër që të miratojë kërkesën e Senatit të Universitetit "Fan Noli", me vendim nr. datë 20.01.2009 për hapjen në qytetin e Pogradecit të filialit të universitetit "Fan S.Noli", Fakulteti Ekonomik, programin e studimit Turizëm, Diplomë e Nivelit të Parë.

Stadiumi nuk do të prishet

Një tjerët investim madhor do të jetë edhe rikonstrukcioni i lumit të qytetit me vlerën prej 42.150.000 lekë. Por këto investime që janë edhe si prioritet të punës së Bashkisë kanë një specifikë pasi kanë një shtrirje kohore në dy vite buxhetore

Investime të mëdha do të thithë edhe stadiumi i qytetit të Pogradecit; një fond total prej 55.000.000 lekë për objektin rikonstrukcion i stadiumit dhe ambienteve përreth tij. Të planifikuara nga buxheti i vitit 2009 janë 25.000.000 lekë dhe u kërkua që të planifikohen nga shtesat në grand dhe 30.000.000 lekë ose për vitin 2010. Vlerës totale të financuar nga Bashkia i shtohet dhe vlera prej 50.000.000 lekë të financuara në natyrë nga Federata Shqiptare e Futbollit. Nga këshilltarët u ngrit si shqetësim se a do të ruhet forma që ka stadiumi se ata kanë dëgjuar poshtë e lart se do të prishet dhe do të bëhet katrore. Stadiumi ka përmasa

olimpike dhe një ndërhyrje do të thotë që këto përmasa të luhaten dhe do të sjellë ndryshime. Por kryebashkiaku këmbënguli se nuk ka asnjë prishje të stadimit veç rikonstrukcionit total të tij dhe të ambienteve përreth.

Një tjerët investim madhor do të jetë edhe rikonstrukcioni i lumit të qytetit me vlerën prej 42.150.000 lekë. Por këto investime që janë edhe si prioritet të punës së Bashkisë kanë një specifikë pasi kanë një shtrirje kohore në dy vite buxhetore. Por që të mos ngadalësohet puna dhe investimet të mos bëhen me faza, u kërkua që të bëhet e mundur realizimi i të dy investimeve dhe gjeti mbështetjen e këshilltarëve.

Shëtitorja "Fan Noli" do të "mbillet" me vepra arti

Që të marrë një fytyrë vërtet evropiane kjo shëtitorë, Bashkia e ka gjetur zgjidhjen nëpërmjet shpalljes së një konkursi kombëtar për realizimin e veprave të artit që do të vendosen aty.

Në zbatim të studimeve urbanistike të miratuara për Shëtitorën "Fan Noli", si dhe në mundësitë që ka buxheti i Bashkisë është e garantuar vlera për realizimin e disa veprave arti që do të stolisin atë. Realizimi i veprave do të bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur ku ftohen të marrin pjesë sa më shumë artistë e intelektualë. Një komision profesionistësh do të

bëjë përzgjedhjen e tyre. Për çdo fitues do të ketë çmim.

Cila është ideja e studimit?

Në shëtitorën "Fan Noli" është realizuar një investim serioz dhe studimi parashikon vazhdimin e këtij investimi me shatërvane dhe elementë të tjerë dekorativë. Duke qenë se kjo shëtitorë përbën një aks kryesor dhe ndodhet në qendër të qytetit në të do të vendosen edhe disa vepra arti. Qëllimi është që kjo shëtitorë të kthehet në një shëtitorë "100 hapa drejt Europës." Do të ngrihet një portë e madhe, e cila do të simbolizojë portën e Bashkimit European dhe në të gjithë gjatësinë

e saj do të vendosen 100 pllaka me emrat e 100 figurave më të shquara evropiane. Në pjesën anësore të bashkisë do të ndërtohet një peshk me profil hekuri i ndriçuar me drita që të kthehet në një simbol për qytetin. Në krahun tjetër të shëtitorës do të vendosen të gjithë flamujt e BE-së si dhe flamuri shqiptar. Kjo panoramë do të tërheqë turistët dhe do t'i japë një zhvillim qytetit.

Simboli i peshkut ndezi debatin për emblemën. Emblema është një dhe e përcaktuar e nuk ndryshon, sqaroi Artan Shkëmbi. Simbolet janë shumë në një qytet. Kryetari i

Bashkisë vuri në dijeni këshillin se është ftuar në Këshillin e Europës për të marrë pjesë. Edhe nga Pogradeci do të nisemi për të shkuar në Europë. Cilat figura do të jenë në pllaka, kërkuan të dinë disa këshilltarë. Figurat do të jenë nga më të spikaturat nga të gjitha fushat si arti, kultura, sporti e shkenca. Mund të paraqiten edhe 200 apo më shumë dhe nga këto do të përzgjedhim 100, sqaroi Shkëmbi. Vangjo Gusho kërkoi që a do të përfshihen Homeri dhe Ajnshtajni në këtë kompozim dhe kush do të vendosë për të gjetur figurat më të duhura të Europës.

Emblema është një, ndërsa simbole qyteti ka shumë

1- *Problemi financiar i fillialit. Sa do të ndihmojë Bashkia?*

- Pagesat e stafit akademik i merr përsipër UK. Bashkia vë në dispozicion godinën dhe do të gjejë mundësi për të dhënë ndihmë financiare, për ngrohje, shërbime, do të shohë mundësinë e ndihmës së studentëve për fjetje.

2- *Çfarë investimesh konkrete do të bëhen për stadiumin dhe lumin?*

- Dy investimet, për lumin dhe stadiumin. Për lumin punimet do të bëhen që tek rruga "Kajo Karafili" dhe deri tek pjesa poshtë. Shtrimi do të jetë në një nivel. Gjerësia 12 metra tek bregu i lumit. Të dyja anët të shtruara me të njëjtën nivel. Me dy trotuarë të shtruar me asfalt dhe me ndriçim. Pra, do të jetë një basen dekorativ. Do të vendosen dy rrjeta që do të pengojnë prurjen e inerteve. Këto do të hapen në dimër dhe do të mbyllen në verë për të mos ndotur liqenin në kohën e plazhit. Do të ngrihen edhe prita. Modeli do të jetë si ai i Lanës në Tiranë.

3- *Të na jepej një skicë që të na bindni ne si këshill*

- Skicat janë gati dhe i keni në dispozicion që të studioni.

4- *A do të shkatërrohet stadiumi?*

5- *A kemi të dhëna të sakta për punimet që do të kryhen?*

6- *Në aneksin e stadiumit do të bëhet pallat?*

7- *A qëndron kjo apo është fjalë e dalë rrugëve?*

- Stadiumi nuk do të shkatërrohet. Stadiumi mbetet si është. Ka vdekur ideja e shkatërrimit të stadiumit. Stadiumi mbetet siç është i pa ndryshuar. Do të ndërhyhet në drenazhimin e stadiumit dhe aneksit që të luajnë futboll në çdo kohë. Kemi 15 ekipe të moshave. Federata do të sjell tapet me bar plastik. Stadiumi do të ndriçohet që të luhet natën. Nuk ndryshon as forma, mbetet ajo vezake.

8- *Si do të jenë figurat e Evropës, buste?*

- Nuk do të jenë buste, por vetëm emrat e tyre në pllaka.

9- *Do të vendosim simbolin e 100 personaliteteve apo vetëm emrat?*

- Nuk do të jenë simbolet e tyre, por si u sqaruar, do të jenë vetëm emrat.

10- *Sa do të jetë fondi për projektin?*

- Fondi do të jetë 8 milion lekë të vjetra.

11- *Kush do të jenë këta 100 personalitete më të shquara të Evropës?*

- Figurat do të jenë nga të gjitha



PYETJE

Do të ketë ndriçim stadiumi?

- Stadiumi do të ketë ndriçim që të luhet jo vetëm ditën por edhe natën. A do ta bëjmë Pogradecin një qytet europian?

Pyetje- përgjigje

fushat si arti, sporti, shkenca, politika.

12- *Figurat do të jenë para 90-ës, apo që nga 90-ta e këtej?*

- Nuk do të ketë kufi ndarës në përzgjedhjen e figurave që do të vendosim në qytetin tonë.

13- *Si të heqim një simbol e të vëmë një tjetër, e kemi emblemën?*

- Nuk bëhet fjalë për emblemën e qytetit. Emblema është një, ndërsa simbole qyteti ka shumë. Ne kemi vendosur që të bëjmë një simbol peshku me profile hekuri dhe me ndriçim.

14- *Kur do të mbarojë kompletimi me simbolet dhe pllakat me emra?*

- Të gjitha punimet do të mbarojnë brenda datës 20 qershor.

15- *Vetëm nga sfera politike do të jenë figurat?*

- Nuk do të jenë vetëm nga sferat politike.

16- *Kush do t'i përzgjedhë?*

- Përzgjedhjen do ta bëjë një komision i specializuar. Kryesore është që të kemi pjesëmarrje në prurjen e emrave që do të vendosim. Le të vijnë dhe dy apo treqind. Ne do të përzgjedhim 100 prej tyre. Nuk ka kufizim nga komuniteti në propozime. Edhe ju këshilltarët mund të kontribuoni në këtë konkurim.

17- *Si do të realizohen?*

- Të mbledhim një herë propozimet dhe të sillen materialet për konkurim pa realizimin e shikojmë dhe më vonë.

18- *Po me lumin a do të ujitën lulishtet?*

- Lumin nuk do ta përdorim për ujitjen e lulishteve se për ato kemi një sistem pompash që furnizohen nga liqeni.

19- *Do të ketë ndriçim stadiumi?*

- Stadiumi do të ketë ndriçim që të luhet jo vetëm ditën por edhe natën. A do ta bëjmë Pogradecin një qytet europian?

20- *Do të ndryshojë forma nga vezake në katrore?*

- Nuk do të ndryshojë forma e stadiumit. Do të mbetet siç është vezake.

21- *Mos do të ndërhyhet për të prishur pistën?*

- Nuk ka ndërhyrje për të prishur, ka ndërhyrje vetëm për të rregulluar pamjen.

22- *A do të mbahet stadiumi në përmasat olimpike minimale si i ka apo do të prishen?*

- Nuk ka ndryshim as të përmasave.

23- *Si del që nga biznesi i madh ka mosrealizime të shlyerjes së taksave?*

- Mos u çuditni se ka firma të biznesit

të madh që s'kanë asnjë zyrë dhe s'ke ku i gjen. Ata kanë vetëm një dosje që e mbajnë nën sqetull dhe hyjnë nëpër tendera e janë të regjistruar si të mëdhenj.

24- *Për fondin e sinjalistikës. Si do të përdoret?*

- A po bëjmë trotuare të rinj, bashkëkohorë? Në rrugë të mira duhet patjetër dhe një sinjalistikë e kohës. Nuk kanë më vend tabelat e vogla. Do t'i bëjmë me ndriçim fosforeshent. Rruga e re do tabela të reja të standarteve europiane. Do të bëhen vizimet e bardha.

25- *A do të ulet ky këshill në sallën e re të mbledhjeve?*

- Nga tetori i këtij viti do të mbarojë salla e mbledhjeve dhe kështu që për një kohë do të uleni pastaj nuk i dihet.

26- *A do të ketë ngrohje salla e re?*

- Salla do të ketë ngrohje.

27- *Si do të jetë modeli i sallës së mbledhjeve?*

- Modeli do të jetë si ai i parlamentit, por në përmasa më të vogla.

28- *Cila do të jetë ngjyra e fasadës së Bashkisë?*

- Ngjyra e fasadave të Bashkisë ajo më e përshtatshme për të përfaqësuar qytetin.

Zëra qytetarë

Betimi

"Beto hem, në emër të zgjedhësve që përfaqësoj, të mbroj Kushtetutën e RSH dhe ligjet e saj.

Beto hem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre."

Isha i sigurt se ekzistonte mundësia e realizimit të një goli të tillë: topi godet shtyllën transversale, kurrizin e portierit dhe rrjetë. Kjo mundësi rastisi të ndodhë në sytë e mi në një ndeshje zyrtare në stadiumin e Ersekës.

Isha i sigurt se poezia ime "Thirrje partive": ... /O parti, o ngjyra nderi, / përbashkohij si ylberi..., mund të bëhej realitet. Pikërisht këtë realitet e jetova në mbledhjen e këshillit bashkiak Pogradec të datës 12 shkurt 2009.

Jam i sigurt se gazeta "Nositi" akoma nuk e ka arritur përsosmërinë. "Shpirti" i saj duhet të pasqyrojë akoma më mirë shpirtin e Nositit të krijuar prej Lasgushit, që për zogjtë e vet çan gjoksin dhe i ushqen me gjakun e zemrës, gjë që nuk e bën Nositi i krijuar prej Zotit, dmth pelikani, siç e njeht populli. Nëse gazeta do të kishte arritur përsosmërinë, Ambasada e SHBA nuk do të financonte për suplement të saj vetëm tetë faqe, por gjithë gazetën.

Vite më parë edhe Ambasadori, në TV SOT-7 dha një intervistë. Sigurisht që këto dy raste vërtetojnë përkrahjen e tyre dhe nderimin që u bëjnë vlerave të pogradecarëve.

Në suplement janë vetëm tetë faqe të NOSITIT, datë 26 janar -9 shkurt 2008. Faqja e parë është me foto me ngjyra, ndofta për t'i thënë botuesit: "Kështu dallohet që së largu se NOSITI është "ushqimi" i duhur," gjë që më nxiti mua të marr pjesë në mbledhjen e këshillit bashkiak. Jo vetëm kaq, por ta filmoj fillim-mbarim për ta studiuar.

Çfarë të studioj?! Ja se çfarë!

Ylberi pogradecar

(mbresa nga një mbledhje)



Ishte rastësi që suplementi fillonte me miratimin e buxhetit të Pogradecit, apo ka qëllim t'u thotë këshilltarëve të kryeqytetit të marrin shembullin e pogradecarëve?

Ndoshta është rastësi që del kështu, por kështu duhet vepruar!

Sekretari i këshillit bashkiak, zoti Suat Topçiu m'u përgjigj: "Këshilli përbëhet nga 25 këshilltarë që përfaqësojnë 11 parti".

Mendova se gjithë qytetarët duhet të jenë Nosit. Pra, të 25 duhet të jenë të tillë, por jo! Ata janë vetëm 11 që nuk votojnë politikisht. Të paktën siç pamë në bashkinë e kryeqytetit, në dy mbledhjet e posaçme për miratimin e buxhetit. Dmth vendimet merren me numra politikë dhe zbatohen nga numra aritmetikë. 11-a nuk është e barabartë me 25-ën.

Për çudinë time mbledhja u mbyll dhe unë ngela i bindur se 11=25.

Mbledhjen e çeli kryetari i këshillit bashkiak, z.Gjergji Ilo. Filluan diskutimet. Sa e merrnin fjalën, më ngrinte gjaku, nga që kisha bindjen se do të imitonin këshilltarët e

kryeqytetit. Kisha gabuar. Dikur më kishin mësuar: "Vetëm majmunët imitojnë!"

Në mbledhje asnjëherë nuk u përdor fjala parti. Nuk besoj që arsyeja të ketë qenë rendi i ditës, në asnjë mënyrë jo! Në atë kuvend nuk ishin ulur 11 parti, por dy palë krushq, që kishin të njëjtën arsye për t'u ndier të gëzuar.

Në mbledhje morën pjesë edhe rektori i Universitetit "Fan S.Noli" Gjergji Mero dhe zv.rektori Ali Jashari, të ndriçuar nga heshtja e Yllit të filialit. Zoti Gjergji fillimisht falënderoi kryetarin e këshillit bashkiak dhe atë të Bashkisë për ndihmën, për përkushtimin e tyre maksimal në hapjen e filialit të universitetit. Pasi u miratua filiali, rektori i falënderoi me përzemërsi anëtarët që e votuan unanimisht. Për mbarëvajtjen e këtij filiali do të aplikohet përvoja e atij të Sarandës. Si ndërtesë do të shërbejë ajo e maternitetit që do të zhvendoset në spital, ose kavalishenca, e shpërdoruar për qëllime të caktuara nga Ministria e Mbrojtjes!!!

Vetëm fjala e specialistit për disa projekte, krijoi dyshime për shtigje të mundshme korruptive, por sqarimi deri në hollësi teknike që dha kryetari i Bashkisë Artan Shkëmbi, ishin bindëse për anëtarët e këshillit. Hollësitë u dhanë për disa pika:

1.Për hapjen në Pogradec të filialit të Universitetit "Fan S.Noli", Fakulteti Ekonomik, programi studimi i Turizmit (rektori premtoi edhe për të tjerë në vitet në vazhdim);

2.Për fillimin e procedurës së konkurrimit për realizimin e veprave të artit përgjatë shëtitores "Fan Noli", ku do të shkruhen 100 emrat më të shquar në botë;

3.Rikonstruksionin e stadiumit;

4.Rikonstruksionin e Lumit të Pogradecit, etj.

Drejtimi vëllazëror i mbledhjes nga kryetari i këshillit bashkiak Gjergji Ilo dhe nënkryetari Petrika Tupe, përkushtimi maksimal i mundshëm për qytetin nga kryetari i Bashkisë Artan Shkëmbi, dashuria shumë e madhe që kanë për qytetin të 25 Nositët, anëtarë të këshillit, ishte magjia që për aq kohë sa vazhdoi mbledhja, këshilli bashkiak pluralist 11 partish, u shndërrua mbi Pogradec në Ylber.

Ndërsa thonë se Liqeni është Mrekulli natyre, ndër të shtatat që ka bota gjithsej, Ylberi i Pogradecit është e teta. Përfytyroni dy mbledhjet e këshillit bashkiak të kryeqytetit për miratimin e buxhetit dhe më telefononi nëse konkludova gabim.

Përkundrazi! Kuvendi i Shqipërisë Ylberin e Pogradecit duhet ta ligjërojë: Flamur të Këshillave Bashkiake të Shqipërisë për arsyen e vetme se Himni Kombëtar e detyron: "Rreth flamurit të përbashkuar..." Ndërsa Pogradeci të marrë përvojë nga Saranda, përvojën e filialit të tij, Tirana detyrimisht të marrë përvojën e "Ylberit të Pogradecit" Si qytetar, me këtë rast falënderoj anëtarët e këshillit bashkiak që diskutuan, dhanë mendime, veçanërisht: Gjergji Ilo, Artan Shkëmbi, Syrja Palla, Vangjo Gusho, Bardhi Hyka, Todi Angjellari, Lefter Tanellari, Hasan Laho, Shyqyri Buzo dhe një specialist, emrin e të cilit s'e mësova dot; atij, edhe pse projektet ia mbajnë të kyçura, do t'ia ndërtojnë në përmasa gjigande për të zburuar jo Pogradecin, por shpirtin e pogradecarëve dhe turistëve që do ta frekuentojnë edhe më shumë për shkak të realizimit të projekteve.

Maksut Çallo, qytetar
Pogradec më 14 shkurt 2009

Botimi i këtij suplementi është mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit

LIGJI 9936 datë 26.6.2008

Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë

Objekti i ligjit: Rregullon

- Sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë
- Procesin buxhetor nga pikpamja e:
 - Ø Strukturës
 - Ø Parimeve
 - Ø Bazave
- Marrëdhëniet financiare ndërqeveritare
- Përgjegjësitë për zbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi

Ligji zbatohet në të gjitha fazat e procesit të buxhetit, të cilat janë:

- Z- Përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit
- Zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i buxhetit
- Të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë etj.
- Kontrollin, kontabilitetin, raportimin, inspektimin dhe auditimin e buxhetit

Përkufizime:

Buxhet vendor -tërësia e të ardhurave, shpenzimeve, financimeve të qeverisjes vendore

Përfshin: një fond rezervë dhe një fond kontigjence të pashpërndarë, që miratohet nga këshilli në vendimin e buxhetit vjetor (deri 3 % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, pa transfertat e kushtëzuara). Përdorimi i këtij fondi bëhet me vendim këshilli.

Ø Fondi rezervë -financon shpenzime që nuk mund të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit

Ø Fondi i kontigjencës - përballon efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara

Ø Buxheti është i balancuar, përveç rasteve kur merret hua. Është i balancuar në termat e arkëtimeve dhe të pagesave.

Të gjitha të ardhurat e shpenzimet e buxhetit vendor janë në terma bruto. Buxheti vendor mund të ketë deficit vetëm për shpenzimet kapitale të financuara me hua.

Ligji i buxhetit vjetor -miraton të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e buxhetit shtetit, fondet speciale



qendrore, transfertat nga buxheti shtetit për vitin buxhetor

Fond special -ka si burim të ardhurat tatimore ose jo tatimore për financimin e funksioneve të qeverisjes vendore. Paraqiten në këshill së bashku me buxhetin vendor. Nuk lejohet krijimi i fondeve ekstrabuxhetore.

Ø Krijohet me ligj të veçantë. Qeverisja vendore (qv) nëpërmjet këshillit i propozon Ministrit të Financave.

- Ø Ligji përcakton:
 - qëllimin e krijimit të fondit
 - njësinë administrative
 - mënyrën e financimit dhe balancimit të fondit
 - mënyrën e konsolidimit në llogaritë e qeverisjes vendore
 - kohëzgjatjen dhe mënyrën e mbylljes së fondeve

Procedurat e propozimit e miratimit janë të njëjta si me miratimin e buxhetit. Fondet speciale janë të balancuara dhe nuk mund të ketë deficit.

Menaxhimi i mjeteve monetare - Arkëtimet e pagesat kryhen nëpërmjet llogarisë së thesarit. Njësitë e qv gëzojnë të drejtën e përfitimit të interesit për mjetet e tyre monetare, përkohësisht të lira në llogarinë e thesarit.

Njësi të qeverisjes vendore -njësitë e niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj, që kanë si veprimtari parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore, brenda një territori të caktuar.

Përdorim me ekonomi -përdorim i një sasi dhe cilësie të dhënë të inputeve në një kohë të dhënë dhe me koston më të ulët.

Efektivitet -madhësia me të cilën një produkt kontribuon në arritjen e objektivave të politikës apo të qëllimeve të politikës buxhetore

Eficencë -lidhja ndërmjet produkteve të një programi dhe burimeve financiare dhe njerëzore të përdorura

Program buxhetor -grup veprimesh të njësive që administrohen efektivisht dhe kontribuojnë së bashku në prodhimin e produkteve të identifikueshme dhe të matshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi, në arritjen e objektivave dhe të qëllimeve të politikës buxhetore

Politika buxhetore -rezultat i dëshirueshëm dhe i matshëm për një periudhë afatgjatë

Objektiva të politikës -janë rezultatet specifike të matura në kohë, sasi e kosto dhe që përbëjnë hapa të ndërmjetëm

Inpute -burime financiare, njerëzore dhe fizike të përdorura që finalizohen me prodhimin e produkteve të caktuara

Veprimtari të programeve buxhetore -tërësia e veprimeve në kuadër të një programi, për realizimin e një produkti

Produkte -mallrat dhe shërbimet e siguruar nga kryerja e veprimtarive buxhetore

Menaxhim financiar -tërësia e përgjegjësiave të menaxhimit për miratimin dhe zbatimin e rregullave dhe të procedurave, që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike në dispozicion

Kontroll i brendshëm financiar publik -tërësia e sistemit menaxhial, financiar dhe të kontrolleve të tjera (strukturën administrative, metodat, procedurat si dhe auditimin e brendshëm, të ngritur për realizimin e objektivave të drejtimit) me parim transparencën, ligjshmërinë, përdorimin me ekonomi, eficientë dhe efektivitetin.

Auditim i brendshëm -veprimtari e pavarur që siguron përdorim efektiv të fondeve dhe përmirësimin e ushtrimit të funksioneve të njësive

Shpenzim i taksave -masa e efekteve nga përjashtimet ose lehtësitë fiskale, që ndërmerren për të nxitur veprimtari të caktuara

Parimet e funksionimit të sistemit buxhetor:

- **T r a n s p a r e n c a**, Parashikueshmëria, Gjithpërfshirja, Uniteti dhe universaliteti në menaxhimin e sistemit buxhetor

- Disiplina fiskale në përputhje me stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social

- Shpërndarja e burimeve në përputhje me objektivat

- Përdorim ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve publike

- Përgjegjësi të qarta për menaxhimin operacional

- Respektim me rreptësi i tërësisë së procesit

Transparenca -siguron për këshillat dhe publikun të dhëna lehtësisht të disponueshme, të shpejta,

LIGJI 9936 datë 26.6.2008

të kuptueshme e të krahasueshme, në nivel ndërkombëtar, në lidhje me:

- Ø Funksionet, mënyrën e organizimit, veprimtarinë, rolet dhe përgjegjësitë e njësive të qeverisjes
- Ø Produktet për objektivat dhe qëllimet e politikës
- Ø Procesin e përgatitjes së buxhetit
- Ø Parashikimin fiskal
- Ø Pasqyrat financiare

Klasifikimet buxhetore -miratohen nga M.Financave e përfshijnë:

- a) Klasifikimin administrativ - klasifikimin e njësive të qeverisjes deri në nivel njësie shpenzuese
- b) Klasifikimin ekonomik - klasifikimin e transaksioneve, sipas natyrës ekonomike
- c) Klasifikimin funksional - klasifikim i detajuar sipas funksioneve ose objektivave që njësitet synojnë të arrijnë
- d) Klasifikimi sipas programeve - përfaqëson programet, projektet në përputhje me objektivat
- e) Klasifikimi sipas burimeve të financimit

Buxheti vendor:

Viti buxhetor -Fillon në 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti

Këshilli – Me vendim të veçantë miraton:

- të ardhurat
- fondet buxhetore vjetore
- fondet speciale
- huamarrjen për financimin e projekteve

Kryetari -Propozon drejtimet kryesore të politikës së njësive dhe projektbuxhetin në këshillin përkatës

Përgjegjësitë për menaxhimin financiar përfshijnë:

- Përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, kontabilitetin, raportimin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit
- Sigurimin e përdorimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve publike

Kalendari -për përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit

- Ø Brenda muajit janar - M.Financave paraqet për shqyrtim dhe miratim në K.Ministrave raportin për vlerësimet dhe parashikimet

makroekonomike për:

- 2 vitet përpara vitit buxhetor
- vitin buxhetor
- 3 vitet e ardhshme buxhetore (propozimet për tavanet përgatitore të shpenzimeve për 3 vitet)
- Ø Brenda muajit shkurt -Ministri i Financave dërgon udhëzimet për përgatitjen e buxhetit. Mbi bazën e tyre njësitet përgatisin dhe dorëzojnë kërkesat për programin afatmesëm dhe kërkesat shtesë, sipas udhëzimit të M.Financave

Udhëzimet përmbajnë:

- Tavanet e shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm
- Transferrat e pakushtëzuara
- Procedurat dhe afatet e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe projektbuxhetit vjetor
- Rregullat për ndarjen apo delegimin e funksioneve ndërmjet qq dhe qv
- Mënyrat e llogaritjes së transfertave
- Ø Brenda muajit qershor -Ministri i Financave miraton në KM projektin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm së bashku me propozimin e taveve të shpenzimeve
- Ø Brenda muajit korrik -Ministri i Financave i dërgon Kuvendit një kopje të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm dhe jep shpjegime në

komisionin e financave në Kuvend

Programi afatmesëm ka në aneks:

- mënyrën e llogaritjes dhe shumën e transfertës së pakushtëzuar
- shumën dhe qëllimin e transfertës së kushtëzuar

-taksat kombëtare të ndara me qv

Ø Brenda datës 10 të muajit korrik -M.Financave nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit. Udhëzimi përmban:

- tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit afatmesëm
- rregullat për rishikimin e kërkesave në bazë të taveve përfundimtare

Ø Brenda datës 1 shtator - paraqesin kërkesat e rishikuara të programit afatmesëm dhe kërkesat shtesë me argumenta

M.Financave miraton projektin dhe e paraqet në këshillin e Ministrave bashkë me p/ligjin e buxhetit vjetor. Një kopje të programit buxhetor afatmesëm e dërgon në Kuvend.

Ø Brenda datës 25 tetor -KM miraton me vendim p/buxhetin vjetor programin buxhetor afatmesëm, të rishikuar. 10 ditë pas miratimit nga KM, njoftohet çdo njësi e qv për transfertat dhe taksat e ndara.

Ø Brenda 1 nëntorit -kryeministri i paraqet kuvendit p/buxhetin vjetor – kryetarët e njësive paraqesin për miratim buxhetet në këshill

Ø Brenda 31 dhjetorit -kuvendi miraton p/ligjin e buxhetit vjetor -këshilli miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara. 15 ditë pas miratimit publikohet buxheti në buletin e njoftimeve publike

- Në rast se kuvendi nuk miraton buxhetin, KM me vendim, para ditës së parë të fillimit të vitit buxhetor, autorizon zbatimin deri në fund të muajit të tretë. Shpenzimet nuk mund të kalojnë 1/12 e shpenzimeve faktike

- Në rast të mosmiratimit nga këshilli, deri në ditën e parë të vitit buxhetor, kryetari autorizon të kryhen shpenzime deri në 1/12 e shpenzimeve faktike të buxhetit vendor paraardhës.

Ø Në janar -pasqyrohen ndryshimet në dokumentin përfundimtar

Zbatimi i buxhetit

- Ministri i Financave nxjerr udhëzim për zbatimin e buxhetit në çdo vit buxhetor, para datës të fillimit të vitit buxhetor.

Mbledhja e të ardhurave:

- Të ardhurat e miratuara në ligjin e buxhetit vjetor përbëjnë kufirin minimal për t'u arkëtuar gjatë vitit. Depzitoohen në llogarinë e thesarit, edhe ato të pamiratuara në vendimin e këshillit. Të ardhurat e papërdorura trashëgohen (nga taksat, transfertat e pakushtëzuara)

Kryerja e shpenzimeve:

- Fondet e miratuara në vendimin e buxhetit përbën kufirin maksimal të shpenzimeve

- E drejta për të kryer shpenzime skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nga kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare.

- Për kontratat shumëvjeçare, e drejta për të kryer shpenzime mund të zgjatet përtej vitit buxhetor, por jo më shumë se tre vjet pas përfundimit të vitit buxhetor. Kontratat dhe afatet e zgjatjes së të drejtës për të kryer shpenzime përcaktohen me dispozitë të veçantë në ligjin e buxhetit vjetor për vitin pasardhës.

- Shpenzimet e kryera në vitin buxhetor, për llogari të fondeve në vitin paraardhës, regjistrohen e raportohen të ndara nga ato të miratuara në vitin buxhetor.

- Pas miratimit të detajimit të fondeve buxhetore, bëjnë pagesa





Edhe unë jam PJESEMARRES



LIGJI 9936 datë 26.6.2008

Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë

brenda limiteve dhe afateve të përcaktuara.

Rishpërndarja e fondeve:

- Për buxhetin e miratuar në nivel programi

Kush miraton rishpërndarje fondesh:
- ndërmjet programeve miratohet nga këshilli

- e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program, miratohet nga kryetari

- rishpërndarjet ndërmjet zërave të shpenzimeve korente, brenda të njëjtit program, miratohet nga kryetari

- brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korente, ndërmjet njësisë të ndryshme shpenzuese, miratohen nga nëpunësi autorizues i njësisë, nga e cila varet njësisë.

(Për rishpërndarjet vihet në dijeni këshilli me shkrim: për arsyet e rishpërndarjes, masën, ndryshimet dhe pas kësaj vihet zyrtarisht në dijeni thesari)

Kërkesat për fonde shtesë (Nëpunësi autorizues shqyrton kërkesat)

Shoqërohen me justifikimin e paraqitjes së kërkesës:

- Arsyet e mosplanifikimit në kohën e përgatitjes së buxhetit

- Produktet që përfitohen nga kërkesa shtesë

- Kontributin në qëllimet dhe objektivat e politikave

- Zëra të miratuara, që mund të reduktohen për sigurimin e fondeve të nevojshme si dhe pasojat mbi arritjen e objektivave

Kur kërkesa nuk plotësohet, propozohet përdorimi i fondit rezervë.

Rishikimi i zbatimit buxhetit

- Kryetari bën analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe në rast se është e nevojshme edhe propozimet për ndryshimin e vendimit të këshillit.

- Procedura e shqyrtimit,

miratimit e zbatimit të ndryshimeve është e njëjtë me atë të miratimit të buxhetit vjetor.

- Rishpërndarja e fondeve ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti.

Plani i flukseve të arkës së buxhetit

- Plani i arkës mbështetet në fondet e miratuara për vitin buxhetor

- Plani i arkës përfshin:

Ø Fluksin e të ardhurave të parashikuara për t'u mbledhur dhe arkëtime të tjera

Ø Planin e prokurimeve e angazhimeve të tjera

Ø Pagesat e parashikuara

- Plani i arkës respektohet (transferat e pakushtëzuara), ndiqet nga zyrat e thesarit sipas udhëzimeve

- Zyra e Thesarit planifikon emetimin e borxhit për të siguruar gjendje të likuiditeteve.

Angazhimet buxhetore dhe menaxhimi i tyre (detyrime financiare të shkruara, kontrata, hua)

- Qv mban të dhëna për angazhimet financiare

- Nuk mund të ndërmerren angazhime të reja përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara (fond i miratuar sipas klasifikimit buxhetor dhe i vënë në dispozicion të qv)

- Për shpenzimet që mbuloohen me hua me vendim këshilli, thesari nuk lejon marrjen përsipër të angazhimit deri në transferimin e fondeve nga huadhënësi në thesar.

- Në vitin pasardhës mbarten mjetet monetare të papaguara në fund të vitit korrent (jo për angazhimet e anuluar, ose inaktive)

- Mjete monetare të angazhimeve të viteve të mëparshme që anulohen gjatë vitit buxhetor, kthehen në thesar për t'u përfshirë në buxhetin e vitit në vijim

- Angazhimet e anuluar gjatë të njëjtit vit, mund të riaktivizohen për të njëjtat qëllime

- Angazhimet jashtë vendimit të

këshillit, nuk përfshihen si pjesë e detyrimeve financiare

- Kur nëpunësi autorizues i qv merr përsipër angazhime jashtë fondeve të parashikuara në buxhet, është përgjegjës për shlyerjen e detyrimit.

III. Huamarrja

- Këshilli ka të drejtën e marrjes së huasë dhe dhënien e garancive

- Huaja atafatgjatë miratohet nga M.Financave

Ø Procedurat

Ø Limitet

Ø Efektet e huasë

- Kur merret hua nga qv

a) Raporti i tepricës operative = (ardhura operative - shpenzime jo të kushtëzuara)

shërbimi i borxhit + kosto borxhi

jo më pak se 1,4:1

Raporti i stokut të borxhit

b) jo më shumë se 1,3:1 Ardhurat operative nga burimet e veta

Kufiri maksimal vjetor i shërbimit të borxhit

c) nuk kalon masën 20%

Të ardhurat mesatare të 3 viteve të mëparshme fiskale

IV. Monitorimi, Auditimi

- Kryetari i paraqet për informim këshillit një kopje të raportit të monitorimit dhe zbatimit të buxhetit.

- Qv janë përgjegjëse për ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm menaxhimi e kontrolli financiar dhe të një funksioni të pavarur të auditimit të brendshëm

Auditi i brendshëm siguron që burimet:

- janë shpenzuar, dokumentuar dhe raportuar saktë (sigurojnë besueshmëri)

- kanë kontribuar në arritjen e qëllimeve dhe objektivave

- janë përdorur në mënyrë eficiente, ekonomike, efektive

- nuk janë vjedhur e shpërdoruar

Njësitë qv i nënshtrohen auditit të jashtëm (KLSH)

Përgatiti: *Lindita Oshafi*

Vlerësim për
buxhetin 2008

vijon nga faqja 5

2-Shpenzime gjithsej
339.303.095 lekë

3-Të ardhura që trashëgohen
për vitin 2009 janë 11.435.721 lekë.

Të ardhurat për vitin 2009 shtohen
me 11.435.721 lekë dhe këto do të

përdoren për investime në
sinjalistikën e rrugëve të qytetit

2.500.000 lekë dhe në
rikonstruksionin e zyrave të Bashkisë

dhe ngritja e sallës së re të
mbledhjeve të këshillit të Bashkisë.

Aprovimi i buxhetit për vitin 2009 u
krye në muajin dhjetor 2008.

Mbështetur në ligjin 9936 datë
26.06.2008 "Për menaxhimin e

sistemit buxhetor në Republikën e
Shqipërisë" dhe rakordimi i të

ardhurave që trashëgohen është
bërë në muajin janar 2009. Sipas

këtij aktrakordimi me Degën e
Thesarit Pogradec, të ardhurat që

trashëgohen janë në vlerën
11.435.721 lekë. Rishpërndarja u

krye për investime në sinjalistikën e
rrugëve dhe në rregullimin e

mjediseve të Bashkisë si në zyra,
fasada e jashtëme e saj dhe në

ngritjen e një salle ku do të mbledhen
këshilltarët, e cila do të jetë me

sistem ngrohje dhe me aksesore të
tjerë bashkëkohorë. Këshilltari Syrja

Palla kërkoi që të vlerësohet me nota
maksimale administrata e Bashkisë

për arritjet e vitit 2008. Po me nota të
mira e vlerësoi administratën për

menaxhimin e buxhetit edhe
këshilltari republikan Robert

Sadikaj.

Grupi monitorues



Të kujtosh me nderim të thellë ata që vunë në themelet e teatrit profesionist: ëndrrat, pasionet, rininë e tyre... gjithë jetën, është detyrë profesionale dhe qytetare. Brezat e sotëm duhet të njohin këta artistë zemërzjarrtë, që koha u ka hedhur vellon e bardhë të harresës. Në themele ata ishin 10 karafila, një trëndafil dhe një zambak plot ngjyra. Korça njihet në shumë breza për kultivimin e luleve. Karafilat ishin aktorët, trëndafil ishte regjisori S.Mio dhe zambak skenografi i teatrit, vëllai i regjisorit, Piktori i Popullit Vangjush Mio... Sot do të shkruaj për të ndjerin Aleko Skali.

Alekua lindi në qytetin e Korçës në vitin 1922 nga një familje farmacisti. Studioi në liceun francez të qytetit, për pesë vjet. I apasionuar pas teatrit u angazhua në grupin amator që në vitin 1937, ku interpretonte Dhimitër Trajçe, Vangjo Grabocka, Nuçi Shedollari, etj... "Artet e bukura" e quanin grupin. Alekua kishte kulturë të gjerë letrare. Ishte miku i shkrimtarëve francezë.



Ti vure një gur në themele

Në vitin 1947-1948 punoi si gazetar i gazetës, "Fronti Demokratik". Punoi dhe si gazetar i "Radio Korçës" për pak kohë.

Si aktor profesionist ai interpretoi në shumë drama, komedi të autorëve të huaj dhe shqiptarë. Duhet

përmendur roli i parë i tij në filmin "Skënderbeu" në rolin e dhëndrit, tek dasma, ku Skënderbeu i shfaqti dashurinë Donikës. Tek filmi "Përballimi" interpretoi me sukses rolin e avokatit. Pati bashkëpunim me regjisorin Sokrat Mio duke qenë

asistent regjisor, por edhe si bashkëregjisorë.

Një bashkëpunim me regjisorin e porsaardhur nga Rusia, Piro Manin, duke dramatizuar romanin "Këneta". Një sukses i madh për teatrin.

Jo vetëm si regjisor, por edhe si libretist ai realizoi premiera të suksesshme. Humori i hollë dhe loja e singertë bënte për vete spektatorët korçarë. Alekua shkruante tekste të bukura, të ndjera.

Tekstet ia besonte mjeshtrit të fizarmonikës, Abaz Hajros, i cili i bëri këngët të përhapen me shpejtësi në qytet, por edhe nëpër Shqipëri. A më thoni, ka ndonjë qytet që nuk ka korçarë, që këndojnë këngët e serenatave... Së bashku me gazetarin e njohur Andon Mara krijuan libretin e operetës "Së bashku jeta është këngë".

Një këngë të cilën e kam kënduar edhe unë shpesh nëpër rrugicat e qytetit tim të dashur...

Rinin bashkë tek sofati,

Pranë e pranë,

Ndizej zjarri i rinisë

Për sevdanë...

Ai u nda nga jeta në vitin 1978.

Andrea Pepi

Suvenir "Klajmena"



Një emër ky që ka filluar të lakohet shpesh nga qytetarët pogradecarë, por edhe më gjerë, nga vizitorët të rretheve të tjera të Shqipërisë apo dhe të huaj. Dyqani me suvenire gjendet mbi rrugën "Kajo Karafili" përballë valutës, në shërbim të qytetarëve zme një numër të pafund suveniresh. Tek "Klajmena" mund të gjesh gjithçka, duke filluar nga punimet artizanale në dru, bakër, alabastër e qelq, pogradecare e deri tek ato të qyteteve si Kruja, Berati e Shkodra, të njohura për traditën dhe cilësinë në këtë fushë.

Çdokush që ka patur rastin të vizitojë këtë dyqan, vë re qartë se aty pasqyrohet gjithë Shqipëria, nga jugu në veri. Pothuajse të gjitha qytetet shqiptare gjenden të reklamuar aty me bukurinë e tyre natyrale, një pamje panoramike e sjellë aq mjeshhtërisht, por në përmasa shumë herë më të vogla. Suvenire, punime artizanale që flasin për historinë dhe traditën shqiptare... Kjo është dhe një nga arsyet që suvenir "Klajmena" ka vizitorët e saj të huaj, që duan ta njohin më mirë dhe më shumë Pogradecin dhe Shqipërinë, jo vetëm si gjeografi, por edhe në traditë dhe histori.

Mbas disa ditë qëndrimi në Pogradec dhe në Shqipëri ata nuk largohen pa marrë me vete një kujtim për udhëtimin, diçka midis suvenireve si buste të nënë Terezës, Deas, Skënderbeut, apo shqiponjë, flamur, enë kuzhine tradicionale, si buki, kusi, tabaka, në dru dhe bakër, shishe vere, rakie dhe konjaku të veshura me punime në dru etj. Ajo çka e bën të veçantë këtë dyqan suveniresh është okazoni, uljet e çmimeve me raste festash. Kushdo që ka menduar për të bërë një dhuratë, suvenire "Klajmena" është zgjedhja e duhur, e mençur dhe plot surprizë. Për të gjithë ata që duan të zgjedhin suvenir "Klajmena" tani e dinë ku ndodhet. Vizitoheni dhe nuk do të mbeteni të zhgënjyer.




ART CAFFE & ART THEATER

Nje mundesi e shkelqyer per te provuar shijen e lokalit

Kombinuar me shfaqe artistike.
C'do te premtë dhe te shtunë LIVE MUSIC

LIFE NEEDS ART



Adresa
"BULEVARDI I DRINIT"
100 metra nga diga. STRUGE, Maqedoni.

Art Caffe



Horoskopi javor i "Nositit"



Dashi (21.3-20.4)

Do të keni avantazh në raport me të tjerët dhe do të keni mundësi të përfitonit më shumë se zakonisht.



Demi (21.4-20.5)

Do t'ju imponohet një ritëm i ri, më i shpejtë se më parë, pavarësisht nga apatia që ju ka kapur.



Binjakët (21.5-21.6)

Një tratativë me dikë duket se ka hyrë në rrugë të mbarë dhe shumë shpejt do të shihni frytet e saj.



Gaforrja (22.6-22.7)

Shumë prej jush këtë javë do t'i kenë nervat të acaruar. Mos u ngatërroni mes dy personave.




Luani (23.7-23.8)

Duhet të bëni kujdes sepse shërrit është gati të shpërthejë në mjedisin ku punoni ose jetoni.



Virgjëresha (24.8-23.9)

Duhet të zhblokoni një situatë që ka ngecur në momente kritike. Kërkoni ndihmën e dikujt.



Peshorja (24.9-22.10)

Do të ndodheni në ndikimin pozitiv të atyre që keni përreth. Duhet të jeni më aktiv.



Akrepi (23.10-22.11)

Entuziazmi dhe pasioni i ditëve të kësaj jave mund të jenë të zbehta, por vetëm përkohësisht.



Shigjetari (23.11-22.12)

Ndihma që do t'ju ofrohet, duhet të shfrytëzohet. Mund të detyroheni të merrni një udhëtim të shkurtër.



Bricjapi (23.12-20.1)

Pritet të jetë një javë e këndshme për shumicën e të lindurve të kësaj shenje, por tregohuni të shkathët.



Ujori (21.1-19.2)

Një javë fort e mirë parashikohet, sidomos për ata që studiojnë ose merren me krijimtari.



Peshqit (20.2-20.03)

Të zhytur në rutinën e punës nuk do të kuptoni si do të kalojnë ditët e javës, në fund keni një surprizë.



Larg vetmisë

- Burri yt ikën shpesh nga shtëpia në mbrëmje?
- Shumë shpesh. Nuk e duron dot vetminë.

Kujdes për burrin

- Ina, çfarë i jep burrit për të ngrënë, kur nuk i pëlqejnë gatesat e tua?
- Pallton dhe kapelen!

Budallenjtë dhe të martuarit

- Gruaja ime thotë që të gjithë burrat janë budallenj.
- Nuk është e vërtetë, midis nesh ka edhe të martuar.

Mësime nga gruaja

- Duket që së largu që jeni i martuar.
- Si kështu?
- Të gjitha kopsat i keni të qepura.
- Kjo është gjëja e parë që më ka mësuar gruaja në muajin e mjaltit.

Shpresoj të vijë

- Të ka ndodhur ndonjëherë që të mos vijë burri natën në shtëpi?
- Po, ka një muaj. Por megjithatë shpresoj të vijë.



Vipat Top Sekret

David Beckham, fëmijë të katërt

Viktoria Beckham duket se është vënë me mish e me shpirt për t'ia ndryshuar mendjen burrit të saj, për të mos qëndruar në kampionatin italian; Sipas burimeve ajo ka thënë se, derisa David




do të jetojë në Itali, nuk do të ketë një fëmijë të katërt. "Çështja e fëmijës është akoma një pikë e nxehtë" - tregon një burim i besueshëm. Për Viktorian

nuk ka ardhur akoma momenti i duhur, për të programuar lindjen e një fëmije tjetër. E ardhmja e David në Galaxy është akoma e paqartë. Më parë duhet të zgjidhin probleme akoma të lënë pezull. E ardhmja e Viktorias ka tronditur David, i cili ka thënë se në të njëjtën kohë jeta e saj po shkon në drejtimin e duhur. Ai do të luajë ende dhe për ta plotësuar më mirë jetën do të donte dhe një fëmijë të katërt.

Mel C, bëhet nënë

Vajza e fundit e "Spice Girls" ka nxjerrë në dritë një bebe të bukur, të cilën e kanë quajtur Scarlett. Ajo ka lindur në po të njëjtën sallon, ku ishte shtruar dhe kolegja e saj Mel B. Detaji që u bë më vonë publik është se, "Scary Spice", në një intervistë për revistën britanike Closer thuhet se ajo ndodhej në të njëjtën sallë ku ka lindur Mel B. Ajo ka ironizuar dhe për të ardhmen e grupit: "Tani që është dhe një bebe tjetër në grup, do të mendojmë të bëjmë diçka, dhe pse nuk e di se çfarë ankthi do të ishte kjo gjë".



Angeline Jolie, bëhet bionde

Aktorja amerikane Angeline Jolie, është bërë përsëri bionde për xhirimet e filmit të saj më të ri, "Salt". Bashkëshortja e aktorit Brad Pitt, megjithatë është dobësuar tej mase dhe të gjithë gjatë xhirimeve të këtij filmi e kanë vënë re.

1	2		3	4		5	6	7		8	9	
10		11				12				13		
		14				15				16		17
18	19				20					21		22
23				24				25				26
27			28					29			30	
		31				32				33		
	34				35					36		37
38				39				40				41
42			43					44				45
		46				47				48		49
50										51		

KREDI PËR SHTEPI

Ku do të rriten ata nesër, ju e vendosni sot.

B.T.H. + 0%*
Duke filluar nga Libor € + 4.75%

*Për dy vitet e para, më pas duke filluar nga B.T.H. + 2%

www.bpopullore.com

BANKA POPULLORE
SOCIETE GENERALE GROUP

Së bashku për të ardhmen

Përgjigjet e fjalëkryqit të numrit të kaluar (Nr. 457)

Horizontalisht: 1.Apolonia 7.Di 8.Mata 13.La 14.USA 15.Stalone 18.Kilimanxharo 20.Kili 21.Ke 22.Visi 23.Si 24.Akulli 25.Grin 26.Ta 27.BU 18.Ab 29.Madriidi 31.Ese 33.Tru 34.Ana 35.Riga 37.TR 38.Li 39.Kazablanka 42.Mig 44.Ben 45.Oka 46.BA 47.Qoshe 49.Fe 51.LT 53.Isa 54.BR 55.Min 56.Dita 58.Etna 59.Gramozi 60.Asi

Vertikalisht: 1.Al 2.Pakistani 3.Luli 4.Osi 5.Namik 6.Arnold 8.Isak 9.Mao 10.Al 11.Tonin 12.AN 16.Tregu 17.Edinburgu 19.Iliada 22.Vit 24.Adisabeba 27.Berna 28.Arti 29.Maliqi 30.Ivana 31.Polonia 32.Aga 36.IK 40Se 41.AK 42.Malta 43.Esat 48.Ose 50.Edi 52.Tas 55.MR 56.NM

Horizontalisht: 1.Një... pagan 3.Eshtë kryeqyteti i Algjerisë 8."Njeriu me..." roman i D.Agollit 10.Butka i PD, inicialet 11.Tase e volejbollit 12.Akoma 13.Lëvizja e ajrit 14.Jo kundra 15.Aktorja italiane Manjani 16.Inicialet e kompozitorit Morcka 18.Ramis..., ish president 20.Sport dimëror 21.Lloj gjarpëri 22.Jo në Romë 23.Peta i legjendës 24.Pluhur 25.Top jashtë vijës anësore 26. ...Piero, futbollist italian 27.Indiumi në tabelë 28.Këngëtar afroamerikan Robson 29.Këshilli i Rregullimit të territorit 30.Piktori Madhi 31.Ho Shi... 32.Baktereologu Paster 33.Quhej kryeqyteti i ish RF Gjermane 34. ...Noli 35.Jo shumë 36.Fileas..., personazh në romanin e Zhyl Vernit "Rreth botës për 80 ditë" 37.Metal fisnik 38.Tenisti Sampras 39. ...Pot i khmerëve të kuq 40.Mat kohën 41.Kali baba 42.Inicialet e Kadaresë 43.Humoristi Bega 44.Shënime kritike 45.Emër vajze 46.Eshtë Korabi 47.Uji..., hasmi s'fle 48.Ngjyrë 50.Metal fisnik 51.Nikolla e volejbollit

Vertikalisht: 1.Shtet ballkanik 2.Inicialet e Boletinit 3.Fjala e parë në telefonatë 4.Notë muzikore 5.Portieri korçar Kaçi 6.Tase e volejbollit 7.Perëndia egjiptiane e diellit 8.Trim pa zë 9.Koka pa binjaket 11.Lëvizja e ajrit 13.Si nr.6 14."Dama..." balet i Çajkovskit 15.Bosht 16.Rrjedhin nga sytë 17.Zog shumë i vogël tropikal 19. ...Biao 20.Notë muzikore 21.Vozë ose... me verë 22.Gjysmë nervat 24.Peshk deti 25.Medalja e të parit 26.Mao Ce... 28.Ten Hisao... 29.Xhejms..., eksplorator anglez 30.Van... piktor hollandez 31.Zihet mbreti në shah 32.Nja banor myzeqar 33.Lloj gjarpri 34.Mbyll ose... dritën 35.Pol... diktatori kamboxhian 36.Mos folë, veri... gojës 37.Ai dhe ajo 38. ...e Voltës 39.Perla e futbollit brazilian 40.Lidhëzë 41.Ramiz..., ish president 43.Muaj 44.Fara e këngës 45.Termi pa ti 46.Shkrimtari Gorki, inicialet 47.Inicialet e dirigjentit Deda 48.Simboli kimik i galiumit 49.Inicialet e shkrimtarit Agolli

Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO
Në kompjuter: Edlir PODA
Lexoni gazetën në: www.poradeci.com
Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë

Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci" -Pogradec
Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec
Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753
e-mail: afrovitig@yahoo.com;
redaksianositi@yahoo.com